
FINANCIAL REPORTING IN FUNCTION OF ECONOMIC DEVELOPMENT

Agim Kastrati

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, akastrati7@hotmail.com

Abstract: Financial reporting based on International Financial Reporting Standards (IFRS) has a special role for the users of information from financial statements to obtain support for their decisions. Problems in the analysis and comparison of financial reports and differences in taxation practices among countries made necessary the application of International Accounting Standards. Recent years in many countries there is a tendency towards harmonization of the use of IFRS. In this sense IFRS represent a set of accounting standards that enable the compilation of comprehensive and transparent financial reports. The implementation of the Accounting Standards affects the quality and reliability of the financial statements. The reliability of the financial statements and their publication increases the transparency of the financial results of the economic entities. Qualitative financial reporting eliminates irregularities and reduces informality. Reliable financial statements affect the security of lenders and the attraction of foreign investments. In this way qualitative, transparent and reliable financial reporting has a great impact on the economic development of a country since the financial information provided by the financial statements of economic entities has a great influence on the decision making of investors, lenders and other interested parties. There are difficulties in applying accounting standards in practice, as financial reporting standards are complex, voluminous and often changing. Implementation of these standards requires certain knowledge from professionals. The level of application of IFRSs is low, the management of entities is oriented towards tax reporting. Entities are required to prepare up to four sets of financial statements (IFRS, taxes, management and banks). IFRSs provide sufficient basis for reporting for tax purposes. Professionals in the field of financial reporting have nowhere to address their problems. In the labor market in Kosovo, there is a lack of professional staff in the area of financial reporting. Educational institutions should increase the quality of education and produce the staff that the labor market in Kosovo needs;

Keywords: Financial Reporting, Accounting Standards

RAPORTIMI FINANCIAR NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

Agim Kastrati

Kolegji BIZNESI Prishtinë, Kosovo, akastrati7@hotmail.com

Përmbledhje: Raportimi financiar i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) ka një rol të veçantë për përdoruesit e informacionit nga pasqyrat financiare për të patur mbështetje për vendimet e tyre. Problemet në analizën dhe krahasimin e raporteve financiare dhe ndryshimet në praktikën e taksimit midis vendeve e bënë të domosdoshëm zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Vitet e fundit në shumë vende ka një tendencë drejt harmonizimit të përdorimit të SNRF-ve. Në këtë kuptim SNRF paraqesin një seri standardesh të kontabilitetit që mundësojnë përpilimin e raporteve financiare gjithëpërfshirëse dhe transparente. Zbatimi i Standardeve të kontabilitetit ndikon në cilësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Besueshmëria e pasqyrave financiare dhe publikimi i tyre rrit transparencën e afarizmit financiar të subjekteve ekonomike. Raportimi cilësor financiar eliminon parregullsitë dhe zvogëlon informalitetin. Pasqyrat e besueshme financiare ndikojnë në sigurinë e huadhënësve dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Në këtë mënyrë, raportimi financiar cilësor, transparent dhe i besueshëm ka një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi pasi informacioni financiar i dhënë nga pasqyrat financiare të subjekteve ekonomike ka një ndikim të madh në vendimmarrjen e investitorëve, huadhënësve dhe palëve të tjera të interesuara. Në praktikë paraqiten vështirësi në raportimin financiar, pasi që standardet e raportimit financiar janë komplekse, voluminoze dhe shpesh ndryshojnë. Zbatimi i këtyre standardeve kërkon njohuri të caktuara nga profesionistët. Niveli i aplikimit të SNRF-ve është i ulët, menaxhimi i subjekteve është i orientuar drejt raportimit tatimor. Subjekteve ekonomike u kërkohet të përgatisin deri në katër grupe të pasqyrave financiare (SNRF, taksat, menaxhmenti dhe bankat), ndërkaq SNRF-të sigurojnë bazë të mjaftueshme për raportime për qëllime tatimore. Profesionistët në fushën e raportimit financiar nuk kanë ku t'i adresojnë problemet e tyre. Në tregun e punës në Kosovë, ka mungesë të stafit profesional në fushën e raportimit financiar. Institucionet arsimore duhet të rrisin cilësinë e arsimit dhe të prodhojnë staf për të cilin ka nevojë tregu i punës në Kosovë.

Fjalë kyçe: Raportimi financiar, Standardet e kontabilitetit

1. HYRJE

Me zhvillimin e tregjeve të globalizuara të kapitalit, dallimet në standardet e kontabilitetit i bëjnë pasqyrat financiare më pak të kuptueshme dhe të krahasueshme. Palët e interesuara për të dhënat që dalin nga pasqyrat financiare kanë nevojë për informacione krahasuese, prandaj është paraqitur nevoja për zvogëlimin e dallimeve në mes të raportimeve të bazuara në praktikat kombëtare të kontabilitetit. Kontabiliteti njihet edhe si gjuhë e biznesit, prandaj është paraqitur nevoja për përdorimin e standardeve të kontabilitetit në nivel global me qëllim të harmonizimit të raportimit financiar duke eliminuar kështu barrierat kombëtare të përdorimit të informacioneve kontabël. Përdorimi i SNRF-ve në nivel global mundëson raportim financiar të harmonizuar pasi që krijohen mundësitë e zbatimit të parimeve dhe rregullave kontabël të njëjta në mbarë botën. Në këtë mënyrë është imponuar nevoja e eliminimit të barrierave kombëtare të rregullave të raportimit financiar në drejtim të harmonizimit të praktikës së raportimit financiar në nivel ndërkombëtar me qëllim të zvogëlimin të mospërputhjeve duke mundësuar kështu krahasueshmërinë e informacionit financiar për njësitë ekonomike pa marr parasysh vendin e veprimit të saj. Raportimet financiare të harmonizuara i sjellin përfitime ndërmarrjeve të cilat kërkojnë financim, duke reduktuar kostot e të qenit në pajtueshmëri me standardet e ndryshme të kontabilitetit dhe duke u zvogëluar kështu rreziku i informacionit për ofruesit e kapitalit si rezultat i besimit në informacionet e pasqyrave financiare të përgatitura në bazë të SNRF-ve.

Përparësitë e raportimit financiar bazuar në standarde janë të pakontestueshme, por standardizimi dhe harmonizimi në sferën e raportimit financiar ka edhe të metat e veta. Në këtë mënyrë disa hulumtues kanë paraqitur qëndrimet e tyre kundër harmonizimit të raportimit financiar për shkak të mos marrjes parasysh të mjedisit specifik kombëtar. Disa studiues vënë në pikëpyetje nevojën e standardeve të harmonizuara të kontabilitetit duke i trajtuar si të pa nevojshme për pjesëmarrësit në tregjet e kapitalit, me argumentin se për kuptimin e këtyre rregullave janë të nevojshme njohuri të hollësishme. Në disa raste raportimi financiar i bazuar në standarde shihet si detyrim për vendet me ekonomi në zhvillim nga vendet e zhvilluara dhe se standardet ndërkombëtare nuk janë fleksibile dhe nuk marrin parasysh fazat e zhvillimit ekonomik dhe diferencat kulturore. Gjithashtu ka mendime se harmonizimi mund të krijoj mbingarkesë në pikëpamje të përshtatjes me shtesat komplekse dhe të kushtueshme të kërkesave që dalin në lidhje me zbatimin e këtyre standardeve. Autorët të cilët mbështesin kundërshtimet e harmonizimit të raportimit financiar janë të pakt në numër dhe mbisundojnë mendimet e studiuesve lidhur me përparësitë që sjell raportimi financiar i harmonizuar në nivel ndërkombëtar sepse kjo mundëson krijimin e një gjuhe të përbashkët të biznesit e cila mundëson krijimin e raportimeve financiare transparente dhe të krahasueshme në çdo cep të botës.

Në anën tjetër njësitë ekonomike kanë për detyrim të raportojnë në formë të veçantë për qëllime tatimore gjë e cila dallon nga raportimi financiar bazuar në standarde duke u përballur në këtë mënyrë me një raportim të dubluar gjë që kërkon angazhime shtesë. Kur kësaj i shtohen edhe kërkesat tjera për raportim të veçantë për pronarët dhe për bankat, atëherë profesionistët e kësaj lëmie vihen para vështirësive të shumta duke u përballur me angazhime shtesë të shumëfishta dhe të panevojshme.

Qëllim parësor i informacionit kontabël duhet të jetë raportimi i besueshëm dhe transparent me qëllim që përdoruesit e këtyre informacioneve të jenë në gjendje të bazohen në lidhje me vendimmarrjet e tyre. Në këtë mënyrë raportimi financiar ndikon në mënyrë direkte në zhvillimin ekonomik të një vendi me anë të stimulimit të një kreditimi me kushte të volitshme si dhe duke i joshur investitorët që kapitalin e tyre ta angazhojnë në kushtet e një ekonomie me raportim financiar real, transparent dhe të besueshëm.

2. GJENDJA AKTUALE NË FUSHËN E RAPORTIMIT FINANCIAR NË KOSOVË

Raportimi financiar në Kosovë bazohet në Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Aktualisht çështja e raportimit financiar në Kosovë është e rregulluar me Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (Ligji Nr. 06/L- 032), i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2019. Sipas këtij Ligji, standardet e kontabilitetit duhet të zbatohen varësisht prej madhësisë së ndërmarrjeve, ashtu që ndërmarrjet e mëdha janë të obliguara ti zbatojnë SNRF-të, ndërsa ndërmarrjet e mesme dhe të vogla (NMV) duhet ti zbatojnë SNRF për NMV.

Klasifikimi i ndërmarrjeve në Kosovë:

Tabla 1 **Shumat në €**

Ndërmarrjet	Mikro	Të vogla	Të mesme	Të mëdha
Asetet	<=350,000	<=4,000,000	<=20,000,000	>20,000,000
Qarkullimi	<=700,000	<=8,000,000	<=40,000,000	>40,000,000
Numri i punonjësve	<=10	<=50	<=250	>250

Burimi: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, EVP, Shëngjin 2019

Sipas ligjit aktual një vend të veçantë kanë subjektet me interes publik (SIP), ku hyjnë: Ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe shoqëritë tregtare që i plotësojnë kriteret e për t'u klasifikuar si ndërmarrje të mëdha; Institucionet financiare, që i nënshtrohen licencimit nga BQK; subjektet letrat me vlerë të cilave janë të lejuara për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Kosovës. Subjektet me interes publik duhet të përgatisin pasqyrat financiare në pajtueshmëri me SNRF-të e plota. Këto subjekte duhet të kenë pasqyra financiare të audituara nga një firmë e licencuar e auditimit. Pasqyrat financiare duhet të nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv ose i përgjithshëm dhe nga drejtori financiar ose zyrtari kryesor financiar/kontabilisti i certifikuar. Kërkesat shtesë për raportim nga SIP: Deklarata e pajtueshmërisë – e nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar; Raporti i menaxhmentit – një vlerësim i drejtë dhe i balancuar i zhvillimit të ndërmarrjes dhe performancës; Deklarata e qeverisjes korporative – praktikata e qeverisjes, përshkrimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të rrezikut në lidhje me raportimin financiar; Themelimi i komitetit të auditimit me drejtorë jo ekzekutiv, njëri së paku të ketë përvojë në kontabilitet ose auditim; Auditori i brendshëm – i pavarur dhe të ketë së paku 3 vjet përvojë punë në fushën e kontabilitetit ose auditimit.

Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla duhet të përgatisin pasqyrat financiare në pajtueshmëri me SNRF për NMV. Ndërmarrjet e këtij grupi me qarkullimi mbi 4 milion € duhet të auditohen nga një firmë e auditimit, si dhe të përgatisin deklaratën e pajtueshmërisë. Ndërmarrjet me qarkullim më pak se 4 milion € duhet të kenë raportin e rishikimit në përputhje me standardet e rishikimit nga auditorë ose firmë e auditimit e licencuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF). Pasqyrat financiare nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv dhe nga drejtori ose zyrtari kryesor financiar/kontabilisti i certifikuar.

Ndërmarrjet e mëdha, NMV dhe mikro ndërmarrjet janë të obliguara që ti dorëzojnë pasqyrat financiare në KKRF, jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues (30 qershor të vitit vijues për pasqyrat financiare të konsoliduara). Ndërmarrjet e mëdha, ato me interes publik si dhe NMV i dorëzojnë në KKRF edhe vendimin për miratimin e pasqyrave vjetore financiare dhe vendimin mbi propozimin për shpërndarjen e fitimeve ose humbjeve. Pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të mëdha, SIP si dhe NMV të cilat kanë qarkullim vjetor neto mbi 4 (katër) milion € do të publikohen nga KKRF.

Në Kosovë, niveli i zbatimit të SNRF-ve është i ulët dhe vërehet një mosinteresim i njësive ekonomike në këtë drejtim pasi që menaxhmenti është më tepër i orientuar drejt raportimit tatimor. Njësitë ekonomike janë të obliguara të përgatisin deri në katër sete të raportimeve financiare (SNRF, tatimet, drejtimi dhe bankat). Në praktikë është dëshmuar se SNRF-të ofrojnë bazë të mjaftueshme për raportim për qëllime tatimore (Kastrati, 2016). Me rastin e hartimit të pasqyrave financiare profesionistët e fushës së raportimit financiar hasin në vështirësi të ndryshme dhe nuk kanë ku ti adresojnë problemet e tyre. Në tregun e punës në Kosovë vërehet mungesë e stafit profesional në fushën e raportimit financiar. Institucionet arsimore nuk janë të orientuara sa duhet në ngritjen e cilësisë në fushën e tyre dhe nuk prodhohen kadro për të cilat ka nevojë tregu i punës në Kosovë. Shoqatat profesionale të kontabilitetit të cilat merren me certifikimin e kandidatëve në këtë fushë për mes trajnimeve të rregullta kanë ndikim të madh në ngritjen profesionale në fushën e raportimit financiar. Parimet dhe rregullat tatimore nuk janë të përafuara me raportimin sipas SNRF-ve, njësitë ekonomike janë të detyruara të përgatisin nga dy ose më shumë sete të raportimeve financiare.

3. RAPORTIMI FINANCIAR NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

Raportimi financiar bazohet në aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Zbatimi i Standardeve të kontabilitetit ndikon në ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare. Besueshmëria e pasqyrave financiare dhe publikimi i tyre ngrit transparencën e afarizmit financiar të subjekteve ekonomike. Raportimi financiar cilësor eliminon parregullsitë dhe zvogëlon informalitetin. Pasqyrat financiare të besueshme ndikojnë në ngritjen e sigurisë për kredithënësit. Raportimi financiar i besueshëm ndikon në thithjen e investimeve nga jashtë.

Në këtë mënyrë raportimi financiar cilësor, transparent dhe i besueshëm, ka ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi pasi që informacionet financiare që ofrohen nga pasqyrat financiare të subjekteve ekonomike kanë ndikim të madh në vendimmarrjet, si të investitorëve të ndryshëm ashtu edhe të kredithënësve dhe palëve tjera të interesuara.

Gjetjet nga studimet e ndryshme tregojnë se raportimi financiar i kontrolluar përmes auditimit ndikon në përmirësimin e kontrollit të brendshëm të kompanive (Ghosh, 2007; Shelton & Whittington, 2008). Raportimi financiar i kontrolluar përmes auditimit është i dobishëm lidhur me vendimmarrjet për kredithënie (Guillamon, 2003). Raportimi financiar cilësor shton besueshmërinë e informacionit dhe zvogëlon rrezikun e investimit (Broadley, 2006; Fallatah, 2008). Raportimi financiar cilësor i verifikuar përmes auditimit ndikon në zbulimin e gabimeve dhe mashtrimeve (Hylas & Ashton, 2012).

Në praktikë paraqiten vështirësi pasi që standardet e raportimit financiar janë komplekse, voluminoze dhe ndryshojnë shpesh (Kastrati, 2014). Zbatimi i këtyre standardeve kërkon njohuri të caktuara nga ana profesionistëve. Studimet që kanë shqyrtuar ndikimet e zbatimit të SNRF konfirmojnë probleme në zbatimin e tyre (Jermakowicz 2004, Sucher & Jindrichovska 2004, Hung & Subramanyam 2007). Profesionistët në fushën e kontabilitetit në Kroaci janë ballafaquar me një varg problemesh në zbatimin e SNRF-ve, për shkak të komplikueshmërisë dhe ndryshimeve të shpeshta të tyre (Sacer & Posavec 2012).

Raportimi financiar i bazuar në standarde të kontabilitetit mund të ketë një rol të veçantë në zhvillimin ekonomik të një vendi, pasi që transparenca dhe besueshmëria e raporteve financiare ndikon në vendimmarrjet e shfrytëzuesve të informacioneve si që janë kredithënësit dhe investuesit, kapitali i të cilëve është i një rëndësie të jetike për bizneset e vendeve në zhvillim.

4. PËRFUNDIM

Gjetjet nga literatura tregojnë për probleme të shumta gjatë zbatimit të SNRF-ve por nuk vihet në pikëpyetje zbatimi i tyre. Niveli i njohurive në fushën e raportimit financiar varet nga niveli profesional dhe arsimor si dhe nga niveli i trajnimeve të stafit profesional. Niveli i zbatimit të SNRF-ve është i ulët dhe vërehet një mosinteresim i njësive ekonomike pasi që menaxhmenti është i orientuar drejt raportimit tatimor. Njësitë ekonomike janë të obliguara të përgatisin deri në katër sete të raportimeve financiare (SNRF, tatimet, drejtimi dhe bankat). SNRF-të ofrojnë bazë të mjaftueshme për raportim për qëllime tatimore. Profesionistët e fushës së raportimit financiar nuk kanë ku ti adresojnë problemet e tyre. Në tregun e punës në Kosovë vërehet mungesë e stafit profesional në fushën e raportimit financiar. Institucionet arsimore të angazhohen më tepër në drejtim të ngritjes së cilësisë së arsimit ashtu që të prodhojnë quadro të afta për të cilat ka nevojë tregu i punës në Kosovë. Shoqatat profesionale të organizojnë trajnime të rregullta me qëllim të ngritjes profesionale në fushën e raportimit financiar. Parimet dhe rregullat tatimore të përafrohen me raportimin sipas SNRF-ve, njësitë ekonomike të kursehen nga përgatitja e dy ose me shumë seteve të raportimeve. Të mundësohet përfaqësimi i grupeve të interesit gjatë hartimit të rregullave tatimore. Shoqatat profesionale të angazhohen në formimin e një trupe profesionale këshilluese ku profesionistët do të mund ti adresonin kërkesat e tyre për zgjidhjen e problemeve dhe të shikohet mundësia e botimit të një reviste profesionale. KKRF të veprojnë në drejtim të ngritjes së vazhdueshme të kontrollit të cilësisë në lëmin e raportimit financiar. Të organizohen takime me drejtimin e njësive ekonomike me qëllim të vetëdijesimit për rëndësinë e zbatimit të SNRF-ve.

LITERATURA

- Blechová, B. (2012). The Analysis of the Corporate Financial and Tax Accounting in the EU and their Harmonization.
- Hoti A. (2019). Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, EVP, Shëngjin, 2019.
- Ligji 04/L-014, Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (2011);
- Ligji 06/L-032, Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (2018)
- International Accounting Standards Board (IASB), IFRS for Small and Medium-Sized Entities, London: IASB, 2009
- Epstein, JB and Jermakowicz, (2010). Interpretation and Application of International Financial Reporting Standards, New Jersey: John Wiley & Sons. Inc.
- Gavana, G., Guggiola G. and Marenzi A. Tax Impact of International Financial Reporting Standards: Evidence from a Sample of Italian Companies, 2010, Università dell'Insubria facoltà di economia.
- Gokulnaath .M & et al, (2015), Implementation of International Financial Reporting Standards - Challenges Ahead IRJBM – (www.irjbm.org) Volume No – VIII, January – 2015, Issue – 2.
- Kastrati A. (2014), “Raportimi financiar dhe vështirësitë e bizneseve në Kosovë” “Globale Challenge” nr. 9.

- Kastrati, A. (2016), EUROPEAN ACADEMIC RESEARCH Vol. III, Issue 11/ February 2016 ISSN 2286-4822
www.euacademic.org
- Sacer, M, Posavec, S. R., (2012): Analiza problema praktične primjene međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja u Republici Hrvatskoj, Ekonomski pregled, 63 (9-10) 541-560
- Sumaiya F. (2016), International Financial Reporting Standards (IFRS), research Ambition (An Multinational interdisciplinary E – Journal) Vol. 1, Issue – 2, August, 2016 Pg. 198-207 ISSN NO. 2456 0146.
- Virgil Nbellah A. & Gayomey J., (2016), IFRS / IAS Adoption and its Tax Challenges and Management, The International Journal Of Business & Management (ISSN 2321–8916), Vol 4 Issue 5 May, 2016 Pg. 197 – 210
www.theijbm.com